



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Autoriteti i Konkurrencës  
Autoritet za Konkurrenciju - Competition Authority

Vendimi Nr.15/24  
Datë: 14.02.2024

Duke u bazuar në nenin 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe neni 55 nën paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-056, Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023, Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbledhjen e datës 14.02.2024, mori këtë;

## V E N D I M

**I. LEJOHET.** Përqendrimi i ndërmarrjeve lidhur me blerjen e 100% të kapitalit aksionar nga Nova Ljublanska Banka d.o.o., (blerës), Biser Holdings Limited dhe European Bank for Reconstruction and Development (shitësit) mbi kompaninë SLS HOLDCO (targeti).

**II.** Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguajë taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (njëmijë euro), dhe Vendimin për Realizimin e Përqendrimit, në përputhje me nenin 55.1.5 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashhtë mijë Euro).

## Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë, 21.12.2023, me Nr. Prot. 637/23-11/H ka pranuar kërkesën për Njoftim të Përqendrimit, lidhur me blerjen e 100% të kapitalit aksionar nga Nova Ljublanska Banka d.d, (blerës), Biser Holdings Limited dhe European Bank for Reconstruction and Development (shitësit) mbi kompaninë SLS HOLDCO (targeti).

## Procedurat e ndjekura

1. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 17.01.2024
2. Njoftimi për realizimin e përqendrimit, në web faqen e AKRK-së më datë 19.01.2024
3. Palët në Përqendrim kanë lidhur Marrëveshje për Blerjen e Aksioneve, të nënshkruar më 30.11.2023

## Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

1. Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtar e kalon shumën 20,000,000 Euro.
2. Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumën 1,000,000 Euro.
3. Marrëveshja e lidhur në mes të palëve në Përqendrim, për Blerjen e Aksioneve, nënshkruar më 30.11.2023

Nova Ljublanska Banka d.d., është shoqëri aksionare e themeluar dhe e rregulluar sipas legjislacionit Slloven, me seli në Lubjanë dhe adresë biznesi në Trg republike 2, 1000 Lubjanë, regjistruar në regjistrin Slloven të Bizneseve me Nr. 5860571000 (referuar si “Blerësi” ose “Marrësi”);

Biser Holdings Limited, është një shoqëri e liruar në Ishujt Kajman, me seli të regjistruar në zyrat e në Walkers Corporate Limited, Cayman Corporate, me adresë Hospital Road, George Town, Grand Cayon KY1-9088 (shitësi 1).

European Bank for Reconstruction and Development, është organizatë ndërkombëtare e themeluar në bazë të traktatit, me seli qendrore në pesë (5) Bank Street, Londër, E144 BG, Mbretëria e Bashkuar (shitësi 2).

SLS HOLDCO, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit slloven, me seli dhe adresë Bleiweisova cesta 30/ 1000 Ljublanë, e regjistruar pranë regjistrin tregtar me numër të regjistrimit 9175628000 (targeti). SLS Holdco, është kompania mëmë e ofruesit të financave të makinave, Summit Leasing Slovenija, në një përpjekje për të rritur shërbimet e saj të qiradhënies për sendet e luajtshme.

NLB do të blejë SLS HOLDCO nga filialet e Apollo Global Management dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

#### **Tregu përkatës:**

**Tregu i produktit:** Tregu i shërbimeve financiare, lizingu financiar, lizingu operacional, kredi për konsumatorë etj.

**Tregu gjeografik:** në transaksionin e propozuar është territori Sllovenisë dhe Kroacisë.

#### **Analiza e konkurrencës**

Transaksioni i propozuar nuk ngritë ndonjë shqetësim për konkurrencën në tregun përkatës të Republikës së Kosovës, duke pasur parasysh që nuk rezulton në asnjë mbivendosje horizontale ndërmjet palëve në tregun e ngushtë në Kosovë, për arsye se NLB SH.A nuk ofron shërbime të lizingut në Kosovë, që domethënë se palët nuk veprojnë në treg të njëjtë të produktit. Ndërsa targeti nuk është fare prezent në Kosovë dhe shërbimet e lizingut i ofron në tregje të ndryshe jashtë Kosovës. Shitësi dhe Targeti si dhe kompanitë e tjera brenda SLS HOLDCO asnjëherë nuk kanë ushtruar ndonjë aktivitet në Kosovë, qoftë përmes shitjeve apo ndonjë filiali. Transaksioni nuk ngritë asnjë shqetësim për konkurrencën, pavarësisht përcaktimit të saktë të tregut në Kosovë.



### **Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar**

Kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë, për arsye se Blerësi është prezent në territorin e Republikës së Kosovës, respektivisht përmes filialit të tij NLB Banka SH.A, një shoqëri aksionare që ushtron aktivitete bankare dhe financiare sipas ligjeve të Kosovës, e cila lidhet me veprimtarinë bankare dhe disa veprimtari financiare të caktuara. Mirëpo duke pasur parasysh që tregu bankar në Kosovë është mjaft konkurrues tek shërbimet bankare pasi që kemi një numër të madh të bankave që kryejnë këto shërbime, prandaj ky treg nuk është treg i koncentruar dhe si i tillë nuk ngritë ndonjë shqetësim për konkurrencën dhe konsumatorët në Republikën e Kosovës.

Sipas vlerësimit të përqendrimit, nga ky transaksion nuk do të ketë efekte negative për konkurrencën, e rrjedhimisht për konsumatorët në Republikën e Kosovës. Nga të dhënat e ofruara konsiderojmë se implementimi i transaksionit nuk do të ketë efekt negativ në tregun kosovar, e rrjedhimisht nuk ka mundësi të kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës në tregun përkatës.

Komisioni ka konstatuar se përqendrimi i njoftuar bie në fushëveprimin e Ligjit, pasi i plotëson kërkesat e nenit 13 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 nenit 15 dhe nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-056, Për Mbrojtjen e Konkurrencës, andaj ka vlerësuar se si i tillë, referuar nga "Njoftimi" nuk do të paraqesë efekte negative për konkurrencën, sepse nuk do të rezultojë në kufizim të konkurrencës, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese, të pjesëmarrësve, në përqendrim, përkatësisht objekti i kontratës nuk korrespondon në mënyrë direkte apo indirekte, me tregun përkatës, në Republikën e Kosovës.

### **Shënim:**

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti-konkurruese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij, Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I KONKURENCËS

Neime Binaku-Isufi  
Kryetare

Kaltrina Sela  
Zv. Kryetare



Nafije Osdautaj  
Anëtare



Florent Mehmeti  
Anëtar



Salihe Gashi-Loku  
Anëtare



III. Me këtë Vendim, të njoftohen:

- Palët
- Arkiva